



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 27.01.2017

Vendim
Nr. 15, datë 27.01.2017

**PËR MIRATIMIN E GRUPEVE MËSIMORE ME KARAKTER KËRKIMOR-
SHKENCOR TË DEPARTAMENTIT TË EKONOMIKSIT
NË FAKULTETIN E EKONOMISË**

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 25 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të rekomandimeve të MAS për organigramën e fakulteteve dhe mungesën e grupeve mësimore e kërkimore (Raporti i Inspektimit nr 5265, prot, datë 01. 08. 2014, faqe 7), dhe në zbatim të Vendimit Nr. 32 të Senatit Akademik, datë 06. 09. 2016, "Për fillimin e procesit të riorganizimit akademik dhe administrativ të institucionit dhe hartimin e strukturës së përgjithshme të tij", Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.01.2017

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Ekonomiksit nr. 36 prot, datë 25.01.2017 për ngritjen e grupeve të përkohshme me karakter mësimor si vijon:

- a) Grupi mësimor i Teorisë Ekonomike dhe Mikroekonomiksit;
- b) Grupi mësimor i Makroekonomiksit dhe i Ekonomiksit të Aplikuar.

2. Këto njësi bazë dhe emërtimi i tyre të reflektohen në strukturën dhe organikën e re të Fakultetit të Ekonomisë dhe Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Rektori, Kancelari, zv/Rektori, Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, përgjegjësit e njësive bazë të Fakultetit të Ekonomisë, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

2. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.